



Republika e Kosovës Republika
Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta Ministry
of Culture, Youth and Sport**

Prishtinë, Mars 2025

**THIRRJA PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PROFESIONALE
NËPËRMJET MBËSHTETJES FINANCIARE STUDIMORE NË FUSHËN
E KULTURËS, TRASHËGIMISË KULTURORE DHE SPORTIT
PËR VITIN 2025**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), për vitin 2025 rendit ndër prioritetet programore ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimin e kuadrove në fushat e kulturës, trashëgimisë kulturore dhe sportit. Theks të veçantë ka edukimin artistik të të rinjve, mbështetjen e hulumtimeve, kërkimeve dhe prezantimeve në fushën e trashëgimisë kulturore dhe edukimit profesional në fushën e sportit.

Të drejtë aplikimi në thirrjen publike për mbështetje financiare studimore kanë individët që dëshmojnë se programi studimor apo programi i specializimit është i profilizuar në fushat specifike të kulturës, trashëgimisë kulturore dhe sportit siç janë të elaboruara më poshtë në kategoritë e thirrjes. Individët mund të aplikojnë në një të njërën nga kategoritë si në vijim:

- 1. Mbështetje financiare për studime në fushën e kulturës;**
- 2. Mbështetje financiare për studime në fushën e trashëgimisë kulturore;**
- 3. Mbështetje financiare për studime në fushën e sportit.**

Përmes kësaj thirrjeje publike do të mbështeten programe të nivelit Bachelor, programe të specializuara në Master, Doktoraturë dhe Pos-doktoraturë për studime jashtë vendit.

Tre kategoritë e listuara më sipër janë të elaboruara në vijim duke zbërthyer synimet, profilet, kriteret e përgjithshme, periudhën e mbështetjes, si dhe shkallën maksimale të mbështetjes financiare.

KATEGORIA E PARË:

Mbështetje financiare studimore në fushën e kulturës

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka për synim edukimin artistik të të rinjve dhe zhvillimin e kuadrove profesionale me fokus në profilet kulturore deficitare. Ky konsolidim kualitativ dhe përmbajtësor i kuadrove që ndërlidhen me kulturën, parashihet të adresohet nëpërmjet mbështetjes financiare për individët të cilët studimet e tyre i kanë të fokusuar në profilet dhe fushat në kulturë të listuara si më poshtë:

1. Menaxhim i artit / Menaxhim kulturor;
2. Histori e artit;
3. Kritikë e artit;
4. Studime bibliotekare / Arkivim;
5. Koreografi;
6. Mjeshtër ndriçues për teatër ose/ dhe film;
7. Mjeshtër i zërit për teatër ose/ dhe film;
8. Kurator/e për galeri;
9. Restaurim i veprave të artit;
10. Të tjera që ndërlidhen me fushat e artit dhe kulturës.

Kush mund të aplikojë:

- Studentët;
- Profesionistët e rinj në fushën e kulturës;
- Profesionistët në fushën e kulturës.

Aplikantët duhet të kenë dëshminë e regjistrimit në njërin nga programet e lartpërmendura dhe të plotësojnë kriteret e thirrjes publike.

Kriteret e përgjithshme janë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës (aplikanti nuk mund të jetë i punësuar në MKRS ose të ketë pozitë të lartë drejtuese në institucionet vartëse të saj);
- Të jetë i/e pranuar/regjistruar në programin studimor Bachelor, Master ose Doktoraturë, Pos-Doktoraturë apo ndonjë program të specializuar jashtë vendit që ndërlidhet me fushën e kulturës;
- Universitetet me ranglistë më të lartë botërore (*sipas Times Higher Education*), kanë përparësi në përzgjedhjen e përfituesve.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Periudha e mbështetjes financiare studimore:

Mbështetja financiare studimore vlen për semestrin e dytë të vitit akademik 2024/2025 dhe/ose për vitin akademik 2025/2026.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 15,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: N/A

KATEGORIA E DYTË:

Mbështetje financiare studimore në fushën e trashëgimisë kulturore

Synim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është mbështetja e hulumtimeve, kërkimeve dhe prezantimeve në fushën e trashëgimisë kulturore me fokus në profilet deficitare. Edhe ky synim parashihet të adresohet nëpërmjet mbështetjes financiare për individët të cilët fokusojnë studimet e tyre rreth fushave dhe profileve në trashëgiminë kulturore të listuara si më poshtë:

1. Arkitekturë – Konservim / Restaurim i Ndërtesave dhe siteve;
2. Planifikim hapësinor / Konservim i integruar - Konservim Urban;
3. Arkitekturë - Konservimi i Arkitekturës Moderne;
4. Inxhinieri konstruktive - Konservim i strukturave historike;
5. Inxhinieri konstruktive - Analizë strukturore të Monumenteve dhe ndërtesave historike;
6. Menaxhim i trashëgimisë kulturore;
7. Menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë për trashëgiminë kulturore;
8. Vlerësimi i ndikimit në trashëgiminë kulturore;
9. Shkenca të Arkeologjisë;
10. Antropologji (fizike, biologjike, kulturore, dhe linguistike);
11. Histori e arkitekturës / Histori e artit;
12. Muzeologji (menaxhim i muzeve, programe kuratoriale, menaxhim i ekspozitave, hulumtim);
13. Konservim dhe restaurim i artefakteve (gur, dru, metal, tekstil, qeramikë etj);
14. Konservim dhe restaurim i strukturave tradicionale të drurit, gurit, çerpiqit - argjilës etj.
15. Turizëm kulturor dhe menaxhim i trashëgimisë kulturore;
16. Të tjera që ndërlidhen me fushën e trashëgimisë kulturore.

Kush mund të aplikojë:

- Studentët;
- Profesionistët e rinj në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Profesionistët në fushën e trashëgimisë kulturore.

Aplikantët duhet të kenë dëshminë e regjistrimit në njërin nga programet e lartpërmendura, dhe të plotësojnë kriteret e përgjithshme.

Kriteret e përgjithshme janë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në

Republikën e Kosovës (aplikanti nuk mund të jetë i punësuar në MKRS ose të ketë pozitë të lartë drejtuese në institucionet vartëse të saj);

- Të jetë i/e pranuar/regjistruar në programin studimor Bachelor, Master ose Doktoraturë, Pos-Doktoraturë apo ndonjë program të specializuar jashtë vendit që ndërlidhet me fushat e trashëgimisë kulturore;
- Universitetet me ranglistë më të lartë botërore (sipas *Times Higher Education*), kanë përparësi në përzgjedhjen e përfituesve.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Periudha e mbështetjes financiare studimore:

Mbështetja financiare studimore vlen për semestrin e dytë të vitit akademik 2024/2025 dhe/ose për vitin akademik 2025/2026.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 15,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: N/A

KATEGORIA E TRETË:

Mbështetje financiare studimore në fushën e sportit

Në fushën e sportit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka për synim ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe kuadrove me njohuri profesionale për menaxhimin dhe administrimin sportiv dhe mjekësinë sportive. Ngritja e kuadrove profesionale në sektorin e sportit parashihet të adresohet nëpërmjet mbështetjes financiare për individët të cilët studimet e tyre i kanë të fokusuar në fushat dhe profilet e sportit të listuara si më poshtë:

1. Administrim / Menaxhim Sportiv;
2. Mjekësi Sportive;
3. Shkenca Sportive;
4. Biznes / Industri Sportive;
5. Gazetari Sportive;
6. Trajner Sportiv;
7. Organizim dhe menaxhim i ngjarjeve sportive;
8. Aktivitet Fizik dhe Shëndet;
9. Të tjera që ndërlidhen me fushën e sportit.

Kush mund të aplikojë:

- Studentët;

- Profesionistët e rinj në fushën e sportit;
- Profesionistët në fushën e sportit.

Aplikantët duhet të kenë dëshminë e regjistrimit në njërin nga programet e lartpërmendura, dhe të plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme.

Kriteret e përgjithshme janë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës (aplikanti nuk mund të jetë i punësuar në MKRS ose të ketë pozitë të lartë drejtuese në institucionet vartëse të saj);
- Të jetë i/e pranuar/regjistruar në programin studimor Bachelor, Master, Doktoraturë, Post-Doktoraturë ose program të specializuar në fushën e sportit, në ndonjërin prej profileve të sportit të lartcekura.
- Universiteti në të cilin është pranuar/regjistruar kandidati, me të cilin aplikon në këtë thirrje për mbështetje financiare, duhet të jetë në shtetet jashtë vendit duke mos përfshirë shtetet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia).
- Universitetet me ranglistë më të lartë botërore (*sipas Times Higher Education*), kanë përparësi në përzgjedhjen e përfituesve.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Periudha e mbështetjes financiare studimore:

Mbështetja financiare studimore vlen për semestrin e dytë të vitit akademik 2024/2025 dhe/ose për vitin akademik 2025/2026.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 15,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: N/A

Dokumentet e nevojshme për aplikim sipas kategorisë:

Dokumentet e nevojshme për aplikim duhet të jenë të radhitura sipas listës së dokumenteve të nevojshme të thirrjes publike, të specifikuar si më poshtë. Aplikimeve të cilave iu mungon ndonjë dokument nga kjo listë, do të eliminohen nga shqyrtimi i mëtejshëm i dosjes.

Aplikimi i individëve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrje publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formularin e aplikimit (të plotësuar dhe të nënshkruar);
2. Formularin e deklaratës të financimit të dyfishtë (në rast se aplikanti është përfitues i fondeve të tjera mbështetëse për të njëjtin program);
3. Formularin e propozim-buxhetit (të plotësuar dhe të nënshkruar);
4. Kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës së Republikës së Kosovës;
5. CV-në ose portfolion;
6. Kopjen e diplomës së shkollës së mesme, kopjen e noterizuar të vendimit për nostrifikimin e diplomës (nëse është diplomë e huaj), si dhe përkthimin zyrtar të diplomës nëse nuk është në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët e regjistruar në nivelin **Bachelor**);
7. Kopjen e diplomës së studimeve bachelor, kopjen e noterizuar të vendimit për nostrifikimin e diplomës (nëse është diplomë e huaj), si dhe përkthimin zyrtar të diplomës nëse nuk është në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët e regjistruar në nivelin **Master**);
8. Kopjen e diplomës së nivelit Master, kopjen e noterizuar të vendimit për nostrifikimin e diplomës (nëse është diplomë e huaj), si dhe përkthimin zyrtar të saj nëse nuk është në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët e regjistruar në nivelin e **Doktoraturës**);
9. Kopjen e diplomës së nivelit të Doktoraturës, kopjen e noterizuar të vendimit për nostrifikimin e diplomës (nëse është diplomë e huaj), si dhe përkthimin zyrtar të saj nëse nuk është në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës (vetëm për studentët e regjistruar në nivelin **Post-Doktoral**);
10. Dëshmi për pranimin/regjistrimin në programin studimor të lëshuar nga fakulteti përkatës; (vetëm për studentët e rinj të vitit të parë që sapo janë pranuar/regjistruar në fakultetin përkatës për të cilin kërkohet mbështetja);
11. Dëshmi për vijueshmërinë e studimeve në programin studimor të lëshuar nga fakulteti përkatës (vetëm për studentët që tanimë vijojnë studimet në programin përkatës për të cilin kërkohet mbështetja);
12. Transkriptën e notave të vitit/eve paraprake të programit studimor për të cilin individ i aplikon për mbështetje (vetëm për studentët e nivelit Bachelor dhe Master që tanimë vijojnë studimet në fakultetin përkatës për të cilin aplikohet);
13. Programin e studimeve të lëshuar nga fakulteti përkatës (pranohet edhe programi i publikuar në ueb faqet zyrtare të Fakultetit përkatës).

Vlerësimi i aplikimeve:

1. **Vlerësimi administrativ**, që identifikon nëse aplikanti ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.
2. **Vlerësimi përmbajtësor**, që vlerëson:
 - Nëse aplikimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrjeje publike;
 - Nëse aplikimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
 - Nëse kostot e propozimit janë përbrenda shumave të përcaktuara me këtë thirrje dhe në përputhje me çmimet e tregut.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Afati për aplikim:

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm aplikimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati për aplikim është deri me datën 14 Prill 2025.

Mënyra e aplikimit:

Individët duhet të aplikojnë në Thirrjen për Ngritjen e Kapaciteteve Profesionale të Profesionistëve të Rinj vetëm në formularët e paraparë, të cilët janë në dispozicion në ueb-faqen e MKRS-së: www.mkrs-ks.org. Individët duhet të aplikojnë në thirrje vetëm përmes postës elektronike në email adresën: studime.mkrs@rks-gov.net

Aplikimet e shtypura në formë fizike nuk do të pranohen për shqyrtim.

Titulli që duhet shënuar në subjekt të emaili-it:

Aplikim_Ngritja e Kapaciteteve Profesionale_Emri Mbiemri_Sektor (Kulturë, Trashëgimi Kulturor apo Sport)

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: fatbardha.nasufi@rks-gov.net arbresha.leci@rks-gov.net dhe aferdita.fazlia@rks-gov.net, jo më vonë se pesë ditë para mbylljes së ftesës publike.

LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

Formularët që i gjeni brenda ftesës publike:

- Dokumentacioni i specifikuar në sektorin e “Dokumentet e nevojshme të aplikimit”;
- F9. Formulari i aplikacionit;
- F10. Formulari i propozim-buxhetit;
- F13. Formulari mbi financimin nga burimet tjera mbështetëse.

Vërejtje: në rast që aplikimi juaj për nostrifikim të diplomës pranë Qendrës NARIC në MASHTI është në proces e sipër, me qëllim të aplikimit në këtë thirrje publike pranohet dokument vërtetimi i lëshuar nga MASHTI që vërteton se aplikimi juaj për nostrifikim është në shqyrtim dhe ende nuk ka përfunduar. Në rast të përfitimit nga kjo thirrje publike, transferi i mjeteve të përfituara bëhet me rastin e dorëzimit në MKRS të diplomës së nostrifikuar.